

VENDIM
Nr. 1092, datë 28.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 79, DATË 2.2.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE, NDËRMJET FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT DHE MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, ME QËLLIM RINDËRTIMIN, MODERNIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E STADIUMIT KOMBËTAR “QEMAL STAFÄ”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9001, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 79, datë 2.2.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shitesa:

1. Në pikën 1, fjalët “...me kusht ndalimin e ndryshimit të destinacionit...” shfuqizohen.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1. Projekti dhe ndërtimi i modernizuar i Stadiumit Kombëtar “Qemal Stafa” të ketë një destinacion të dyfishtë.

Pjesa qendrore e projektit dhe ndërtimit të ketë destinacion sportiv, publik, të pandryshueshëm, në përputhje me parametrat e Rregullores së Infrastrukturës së Stadiumeve të UEFA-s, botim i vitit 2010, (UEFA Stadiums Infrastructure Regulations, 2010 Edition). Në projekt dhe në ndërtim të integrohen pjesë me destinacion josportiv, në pronësi të shoqërisë anonime, pa kufizime në disponimin e të drejtave të pronësisë, me qëllim plotësimin e destinacionit të stadiumit të modernizuar.”

“1/2. Shoqëria anonime mund të iniciojë procedura për zgjedhjeje, financimi, dhe negocimi për realizimin e projektit të stadiumit, përfshirë edhe pjesën me destinacion josportiv, me subjekte të interesuara, duke bërë pjesë të ofertës, të negociatave dhe transaksioneve me subjektet e interesuara për financimin dhe realizimin e projektit, pjesërisht ose tërësisht, edhe të drejtat ekskluzive të pronësisë për pjesën josportive, të treguar në pikën 1/1.”

3. Në pikat 2 dhe 3, fjalët “... i përfaqësuar nga ministria përgjegjëse për sportin...” zëvendësohen me “... i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për ekonominë...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama